



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – RepublicofKosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 13.6.2024, e cila filloj në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, ( i pavarur), kryesues i Kuvendit, Trieri Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Berat Lahu (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Arbër Limani (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Amir Simnica (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Granit Geci (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

**Munguan:** Hafiz Krasniqi (LDK), Liridon Selmani, (PDK) dhe Kushtrim Mushica (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkyetar, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Donjeta Dragusha, drejtore e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Sibel Halimi, drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Bardh Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Donika Çetta, dejtore e Drejtorisë së Parqeve, Rrahman Qerimi, anëtar i komisionit komunal të aksionarëve nga ekzekutivi, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të medieve.

Faqe 1 nga 12

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, i cili hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

**Petrit Reçica**, propozoi që në rend dite të futet pika: "Diskutim për hapësirat publike të bibliotekës "Hivzi Sulejmani" dhe jetës kulturore të komunës së Prishtinës.

**Gëzim Sveçla** propozoi që në rend të ditës të futen edhe pikat: "Propozim-vendimi për shkarkimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike komunale "Stacioni i Autobusëve"" dhe "Propozim-vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike komunale "Stacioni i Autobusëve"".

**Valbona Ajeti** propozoi që pika e pestë e rendit të ditës, që ka të bëjë me Propozim-vendimin për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në emrin e humanistik, dr. Gani Demolli, nga pika e pesë të zhvendoset në pikën e dytë të rendit të ditës.

**Gëzim Mehmeti** propozoi që në rend të ditës të futet edhe pika që të diskutohet nga kryetari, rreth procedurave dhe formës se si është menduar që Stacioni i Autobusëve t'u jepet ndërtuesve.

**Bardh Krasniqi**, drejtor, propozoi që në rend të ditës të futet pika: "Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve për klube dhe organizimi i eventeve të kryeqytetit".

**Alban Zogaj**, nënkyetar, propozoi që në rend të ditës të futet pika: "Propozim-vendimi për formimin e Forumit për transparencë komunale në Komunën e Prishtinës".

**Arbër Sadiku**, drejtor, propozoi që në rend dite të futet edhe pika: "Propozim-vendimi për lënie në shqyrtim publik të Planit zhvillimor komunal, 2024-2032.

**Kryesuesi** i hodhi në votim propozimet e dhëna.

**Kryesuesi** konstatoi se më 24 vota për, 10 kundër dhe 1 abstenim, u miratua propozimi i z. Reçica.

**Kryesuesi** konstatoi se më 18 vota për, 22 kundër dhe 1 abstenim, nuk u miratua propozimi i z. Sveçla.

**Kryesuesi** konstatoi se më 39 vota për, u miratua propozimi i z. Ajeti.

**Kryesuesi** konstatoi se më 19 vota për dhe 18 kundër, u miratua propozimi i z. Krasniqi, drejtor.

**Kryesuesi** konstatoi se më 21 vota për dhe 16 kundër, u miratua propozimi i z. Zogaj, nënkyetar.

**Kryesuesi** konstatoi se më 19 vota për dhe 22 kundër, nuk u miratua propozimi i z. Sadiku, drejtor.

*Lidhur me propozimin e z. Mehmeti, për diskutimin rreth procedurave dhe formës se si është menduar që "Stacioni i Autobusëve" t'u jepet ndërtuesve, sqarime të nevojshme dha Përparim Rama, kryetar.*

**Me ndryshime dhe plotësime, kryesuesi konstatoi se më 42 vota për, u miratua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të kryeqytetit;**
- 2. Propozim-vendimi për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me emrin e humanistikit, dr. Gani Demolli;**
- 3. Diskutim për hapësirat publike të bibliotekës "Hivzi Sulejmani" dhe jetës kulturore të komunës së Prishtinës;**
- 4. Propozim-vendim për rritjen dhe bartjen e mjeteve nga tejkalimi i planit për të hyra vetjake nga viti 2023 ne vitin 2024;**
- 5. Propozim-vendime për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024;**
- 6. Propozim-vendime për transferimin e mjeteve;**
- 7. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve për klube dhe organizimi i eveneve të kryeqytetit;**
- 8. Propozim-vendime për formimin e Forumit për transparencë komunale në Komunën e Prishtinës;**
- 9. Raporti vjetor i punës së ndërmarrjes publike lokale "Gjelbër", SHA, për vitin 2023 , si dhe raporti i punës për periudhën janar- prill 2024;**
- 10. Pyetje dhe përgjigje;**
- 11. Të ndryshme.**

Para se të fillohej me pikën e parë të rendit të ditës, **Triera Kasumi-Berisha** tha se sa i përket Propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve për klubet dhe organizimi i eveneve të kryeqytetit, kërkojmë nga drejtori i Drejtorisë të na i sjellë materialet për cilat klube, cilat evenete dhe sa është kostoja e mbështetjes financiare që planifikojmë të bëhet.

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Kryeqytetit.**

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Kryeqytetit.**

**Pika e dytë**

**Propozim-vendimi për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me emrin e humanistikit dr. Gani Demolli.**

Arsyeshmërinë për miratimin e këtij propozim- vendimi në pikë të shkurtar e paraqiti Izet Sadiku, drejtor.

**Gëzim Sveçla** tha se Lëvizja vetvendosje e përkrah këtë propozim- vendim për miratim.  
**Jeta Rafuna** tha se si GP i LDK-së, e mirëpresim dhe e votojmë për miratim këtë propozim-vendim.

**Kumrije Shabani** tha se jam jashtëzakonisht e emocionuar, meqë edhe vetë kam qenë pjesë e atij ekipi, ku kemi punuar me dr. Gani Demollin, i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në themelimin e Shoqatës, në zgjerimin e saj nëpër gjithë Kosovën. Si GP i PDK-së, këtë propozim- vndim e përkrahim për miratim.

**Bahri Gashi**, kërkoi nga drejtori i drejtorisë përkatëse, që të jetë një arsyetim më i zgjeruar dhe që të tregohet se pse ky njeri meriton dhe pse ky njeri është kaq i madh, edhe fatkeqësish pse ky njeri kaq vonë shpërblehet. Kështu që mendoj se duhet cekur patjetër rolin e dr. Gani Demollit në luftën e fundit në Kosovë, rol shumë i madh, angazhim i tijë dhe të stafit të tij në të gjitha zonat e Kosovës.

Si GP i AAK-së këtë propozim-vendim e përkrahim për miratim.

**Ajet Brajshori** tha se propozimi për të nominuar, Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare me emrin e dr. Gani Demollit, është plotësish i arsyeshëm, sepse veprimtaria e tij ka qenë përtej çdo institucioni, andaj me kënaqësi do ta votojmë këtë propozim-vendim, sepse ai ishte njeriu që bëri shumë për popullin e Kosovës dhe për Kosovën.

**Arianit Beqiri** tha se ka shumë njerëz të cilët kanë kontribua gjatë kohërave të ndryshme në historinë për çlirim e Kosovës, dhe nuk mendoj se kemi me mundur me i nderua të gjithë në këtë formë, duke nderuar dikë tjetër e anashkalojmë dikë tjetër, por mendoj që institucionet duhet ta kenë vetëm emrin e tyre në parim, pra çfarë janë, e jo të kenë emra të përveçëm të njerëzve të tjerë.

Këtë propozim-vendim e përkrahim për miratim.

**Fiknete Bejta** u shpreh se edhe unë pajtohem plotësish me propozimin e drejtorit të Shëndetësisë për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me emrin e humanistit dhe mjekut të Prishtinës, dr. Gani Demolli. Shpresoj që krahas arsimit që deri diku iu ka dhënë falënderimi për kontributin e tyre të viteve të 90-ta, t'i jepen edhe mjekëve edhe infermierëve të asaj kohe, sepse puna e tyre ka qenë me plot sfida dhe sakrifica.

**Endrit Zabërgja** shprehu inkurajim për organet komunale, por edhe institucionet tjera që të vazhdojnë me nderimin e heronjve të kombit tonë, sepse duke e nderuar të kaluarën, ne nderojmë vetveten. Në veçanti, dua të shpreh respektin dhe mirënjojen, pasi që jemi në këtë pikë, edhe për heronjtë e gjallë, të cilët kanë qenë pjesë e asaj kohe.

**Kryesuesi konstatoi se më 45 vota për, u miratua Vendimi për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me emrin e humanistit dr. Gani Demolli.**

#### **Pika e tretë**

**Diskutim për hapësirat publike të bibliotekës " Hivzi Sulejmani" dhe jetës kulturore të komunës së Prishtinës.**

**Petrit Reçica** tha se biblioteka "Hivzi Sulejmani" është transformuar që me i shërbyer komunitetit artistik dhe kulturor, komunitetit të lagjes, fëmijëve dhe prindërve të shkollave, si dhe shoqërisë civile në këtë qytet, kështu që i bëjë thirrje Drejtorisë së Kulturës dhe kryetarit, z. Rama, që me ftuar komunitetin në një takim konsultues dhe me i dëgjuar kërkesat e tyre, me liruar hapësirën e bibliotekës "Hivzi Sulejmani", me organizuar një proces pjesëmarrës dhe demokratik se qysh ka me u menaxhuar kjo hapësirë.

**Triera Kasumi - Berisha** tha se për mua është e papranueshme që në mungesë të kreativitetit, Komuna e Prishtinës e kalon Dejtorinë e Kulturës në një objekt, i cili përveç që është vlerë kulturore në pak objekte që i kemi kulturore në Komunën e Prishtinës, krahas madhësisë së kryeqytetit është edhe memorie kolektive shumë e veçantë për të gjithë. Lidhur me këtë kërkoi nga ekzekutivi që të jepet një opinion se cili është vendimi i juaj për këto kërkesa të cilat na janë paraqitur sot.

**Berat Lahun** griti shqetësim rreth gjendjes së bibliotekës "Hivzi Sulejmani", i cili tha se zhvendosja e zyrës së drejtores së Drejtorisë së Kulturës në një objekt kulturor me dekada, i cili ka histori bukur të bujshme, i cili i shërben tashmë edhe një qëllimi shtesë, konsideroj se kjo është keqpërdorimi absolut i pushtetit në arrogancë.

**Arianit Beqiri** tha se jemi duke folur për një precedent shumë të rrezikshëm, që mund të na përsëritet edhe nëpër nivele të tjera, kështu që ne kemi pak hapësira kulturore, artistike dhe ato jemi duke i mbushë me zyra administrative dhe në momentin e parë që hyn në një hapësirë që është e paktë kulturore dhe artistike, kjo nuk shihet mirë, andaj dhe konsideroj se është usurpim. Kërkojmë që menjëherë të bëhet lirimi i hapësirës, si dhe kërkojmë organizimin e një takimi, diskutimi me komunitetin.

**Berna Saracı** shprehu mendimin, duke shtuar se Drejtoria e Kulturës është dashtë me kontaktu me komunitetin artistik kulturor edhe me marrë ndoshta ide se si mundet me u rifunksionalizuar ajo hapësirë, duke i pasur parasysh vështirësitë që i kanë pasur, ose keq menaxhimin e hapësirës edhe stafit, dhe jo direkt me procedu pa një informim të mirëfilltë, ose pa një transparencë të plotë. Do të ishte mirë që të bëhet një deklarim nga drejtoria, qoftë edhe nga kryetari apo nënkyetari, se çka të bëhet me ato hapësira, gjithmonë duke e pas parasysh që komuniteti, sidomos kulturor, artistik, janë ata të parët të cilët e shfrytëzojnë këtë hapësirë.

**Feim Osmani** tha se çdo vendim që merr administrata komunale, në këtë rast për t'i shfrytëzar këto hapësira, do duhej së paku të kishte karakter të përkohshëm, kështu që ky vendim duhet të ndryshohet, do duhej ta kishte karakterin e përkohshëm dhe të arsyetohej natyrisht këtu parapara asamblistëve, sepse ne jemi të thirrur ta diskutojmë dhe ta mbrojmë hapësirën kudo që është në Prishtinë.

**Pëllumb Bajqinovci** tha se Drejtoria e Kulturës ka pasur për qëllim renovimin e objektit, e jo kalimin në pronësi të Komunës së Prishtinës, për arsy se objekti është në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore edhe Komuna e Prishtinës, dhe në këtë rast Drejtoria e Kulturës sigurisht se është vetëm në shfrytëzim edhe në hapat e regjenerimit të asaj pjesës së objektit. Drejtoria e Kulturës i shfrytëzon tri dhoma të vogla edhe hapësira tjeter është në shfrytëzim të komunitetit për aktivitete ditore edhe të tjera, kështu që tash edhe me iniciativën tonë të

bëjmë takime të radhës edhe hapësira sigurisht të shfrytëzohet proporcionisht nga të gjithë. **Gëzim Sveçla** tha se i gjithë komuniteti artistik me të drejtë ankohen, se ka mungesë të hapësirave për artistë dhe tash me e nxënë edhe një pjesë të tyre me zyrë, me staf, me administratë, nuk po më duket që është zgjidhje e mirë, kështu që mendoj se si drejtore e Drejtorisë, ka qenë një mundësi shumë e mirë që këtë çështje me e sqaruar si duhet. Ideja është se si ne të gjejmë një zgjidhje të mirë, e pse jo që edhe autoriteti i juaj si drejtore, ta krijojë mundësinë për të vendosur për një çështje të tillë.

**Leutrim Retkoceri** kërkoi nga ekzekutivi, kryesisht nga Drejtoria e Kulturës, që këto hapësira duhet patjetër të kthehen në qendër kulturore organizatave, që tashmë e kanë drejtuar një kërkese më shumë, se treqind e dhjetë pjesëtarë nga ta dhe nuk mendoj në asnjë moment që kjo kërkese e komunitetit ka lajthitje apo ka terma të cilat u përdorën pa vend gjatë kësaj seance. Andaj ne si Kuvend mund ta nxjerrim një konkluzë, që të zbatohet kërkesa e këtyre dhe të liohen ato hapësira.

**Radie Hoxha** tha se një peticion i gjithë këtyre artistëve që kanë reaguar me të drejtë dhe e kundërshtojnë vendimin e Komunës së Prishtinës për të zhvendosur zyrat e Drejtorisë së Kulturës në ndërtesën e bibliotekës "Hivzi Sulejmani", është më se i arsyeshëm dhe deri më tanë në këtë seancë nuk u fol për një strategji në zgjidhjen e këtij problemi, kështu që dua një qasje më serioze nga drejtorja e drejtorisë, si dhe nga kryetari.

**Fikneta Bejta** tha se ne nuk mundemi me marrë vendim për diçka që është në menaxhimin e drejtorisë, kështu që mos të politizohet një temë që është tërësisht kulturore, mos t'i tejkalojmë kompetencat e Kuvendit dhe kjo çështje shumë kjart u prezantua edhe nga drejtorja e drejtorisë, znj. Halimi.

**Nora Kelmendi** tha se duke pasur parasysh diskutimet rrëth kësaj pike, ne si Kuvend mund të japim rekomandime, i votojmë këto rekomandime pastaj në mbledhjen e ardhshme mund të marrim vendim për lirimin e këtyre hapësirave.

**Ermal Osmani**, në emër të grupit, i propozoi këto rekomandime:

1. Lirimi i hapësirës së ish-bibliotekës "Hivzi Sulejmani" nga Drejtoria e Kulturës;
2. Të organizohet diskutimi publik në mes të Drejtorisë së Kulturës dhe komunitetit artistik.

**Gëzim Mehmeti** tha se Kuvendi ka të drejtë me dhënë rekomandime, dhe nëse tash ka një rekomandim, të qitet në votim që mos të humbim kohë.

**Gresa Lahu**, kërkoi nga drejtorja e Drejtorisë përkatës që të ftohen për një takim pune anëtarët e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, që do të ishte më se e arsyeshme të diskutohet kjo çështje.

**Granit Geci** tha se ky është një rekomandim që Kuvendi ia bënë drejtorisë përkatëse, kështu që nuk ka nevojë ta zgasim më shumë këtë çështje, ta hedhim në votim.

**Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për, 13 kundër dhe 1 abstenim, u miratuan rekomandimet e propozuara nga GP i LVV-së.**

#### **Pika katër**

**Propozim-vendimi për rritjen dhe bartjen e mjeteve nga tejkalimi i planit për të hyrat vetjake nga viti 2023-2024.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Valbona Makolli**, drejtore.

**Nora Kelmendi** kërkoi të dijë se për cilat shkolla profesionale po bëhen këto bartje të mjeteve, si dhe për cilat investime kapitale, projekte kapitale edhe në fushat e tjera bëhen këto bartje. Ne si asamblistë nuk e kemi asnje dokumentacion që tregon për këto bartje dhe kërkoi nga drejtoria e Drejtorisë përkatëse që të na japë sqarime të duhura.

**Fikneta Bejta** tha se ne si GP i LDK-së, këtë propozim-vendim e përkrahim për miratim.

**Leutrim Retkoceri** tha se për të gjitha këto bartje do të kishte qenë me rëndësi arsyetimi i projekteve, sigurisht edhe nga drejtoret, se për ku po dërgohen mjetet nga tejkalimi i të hyrave. Do të ishte mirë që të jemi të informuar edhe prej drejtoreve, se këto mjete që po barten a kanë projekte, kur do të planifikohen të realizohen dhe deri në fund të vitit a do të shohim ndonjë rezultat për qytetarë nga këto projekte.

**Muhamed Selmani**, kërkoi nga drejtoria e drerjorisë përkatëse, që në tabelë të të jenë të precizuara të gjitha ato projekte për të cilat është paraparë bartja e mjeteve, kështu që nëse e votojmë tani si dokument, duhet të jetë i precizuar.

Lidhur me vërejtet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha Valbona Makolli, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për, u miratua Vendimi përritjen dhe bartjen e mjeteve nga tejkalimi i planit për të hyrat vetjake nga viti 2023-2024.**

**Pika e pestë**

**Propozim-vendimin për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024.**

**Valbona Makolli**, propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për në seancën e radhës, me arsyetimin se materiali nuk është i kompletuar.

**Pika e gjashtë**

**Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve.**

Arsyeshmërinë për miratimin e këtij propozim-vendimi e paraqiti Valbona Makolli, drejtore.

**Nora Kelmend**, kërkoi nga përfaqësuesi ligjor, të dijë se a mund të bëhet ndërrimi i ashensorëve, a është në përpjekje me ligjin, pasi që siç e dimë në të gjitha ndërtesat, ndërrimi i ashensorëve bëhet me kërkësë të banorëve, mirëpo duhet të formohet së pari Shoqata e banorëve, pastaj Shoqata të bëjë këtë kërkësë.

**Fikneta Bejta** tha se, si GP i LDK-së, këtë propozim-vendim e përkrahim për miratim.

**Leutrim Retkoceri** tha se është më se e rëndësishme që ne të flasim konkretisht për projekte, cilat janë ato projekte, kur pritet me u realizuar ato dhe pse është e nevojshme të ndahan mjete për projekte e nuk është e nevojshme të ndahan për kontejnerë, për mbeturina apo për një kategori tjetër shumë më të rëndësishme për nevoja të qytetarëve, prandaj do të ishin më se të domosdoshme edhe arsyetimet nga drejtoret e drejtorive.

Lidhur me vërejte dhe pyetjet e parashtruar nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dhan Valbona Makolli, drejtore, dhe Bekim Brestovci, drejtor.

**Muhamed Selmani**, tha se prioritet i këtij qyteti është realizimi i projekteve të rëndësishme, siç janë rregullimi i ashensorëve, po ashtu edhe rregullimi i shtratit të lumbit Llap, e që për këto projekte është dashtë të rialokohen mjete për rregullimin e tyre. Po ashtu, kërkoj të dijë arsyen e mos ri-tenderimit të urës së dytë në fshatin Barilevë.

**Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, u miratua Vendimi për transferimin e mjeteve.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve për klube dhe organizimi i eveneve të kryeqytetit.**

Arsyeshmërinë për miratimin e këtij propozi-vendimi e paraqiti Bardh Krasniqi, drejtor.

**Nora Kelmendi**, fillmisht kërkoi nga përfaqësuesi ligjor, të dijë se a është bërë spastrimi i materialeve nga Zyra Ligjore dhe a janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Bazuar në rekomandimin e auditorëve, ka qenë që subvencionimi i OJQ-ve është bërë pa thirrje publike dhe kryetari duhet të sigurohet që në rastin e subvencionimit të OJQ-ve, të respektohet rregullorja, ashtu që mbështetja financiare të bëhet me thirrje publike, sipas kritereve të përcaktuara dhe të gjitha kërkesat të cilët i keni sjellë këtu, e dini që janë në kundërshtim me legjislaturën në fuqi dhe rekomandimet e auditorit. Ne si Grup i Lëvizjes Vetëvendosje, nuk do t'i përkrahim ndarjen e këtyre subvencioneve, të cilët janë në kundërshtim me rregulloren dhe kornizën ligjore, andaj propozojmë që të hiqet nga rendi i ditës dhe të bëhet subvencionimi përmes shpalljes publike, ashtu siç kërcohët me ligj.

**Jeta Rafuna** tha se ne e përkrahim këtë propozim-vendim për miratim.

**Sami Borovci** tha se në parim jam për me i përkrahur këto klube, normalisht kur ka bazë ligjore, po kjo po besoj që ish dashtë me i kaluar disa filtra ligjor për me u aprovuar si baza ligjore, ose nëse veç vendimi është ligjor. E mbështes këtë propozim-vendim, por kam disa paqartësi te pjesa bazë ligjore.

**Gëzim Mehmeti**, tha se duke pasur parasysh vërejtjet, sugjerimet që u dhan lidhur me këtë propozi-vendim, do të ishte mirë që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Duke pasur për bazë diskutimet rreth këtij propozim - vendimi, Bardh Krasniqi, drejtor, propozoi që kjo pikë të tërhiqet nga rendi i ditës.

### Pika e tetë

#### Propozim-vendimi për formimin e Forumit për transparencë komunale në Komunën e Prishtinës.

Lidhur me këtë propozim - vendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Alban Zogaj, nënkyrytar.

**Feim Osmani** tha se ne nuk do të marrim pjesë në këtë grup, për shkak të mundësive të kufizuar nga aktiviteti i këtij grupei.

**Jeta Rafuna**, për anëtar të forumit, propozoi **zpj. Elmire Nikçi-Rexha**.

Leutrim Retkoceri, për anëtar të forumit, propozoi Gresa Lahun.

**Endrit Zabergja**, për anëtar të forumit, propozoi vetëveten.

**Kryesuesi**, për anëtar të forumit, propozoi Agim Kuletën.

**Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për formimin e Forumit për transparencë komunale në Komunën e Prishtinës.**

### Pika e nëntë

#### Raporti vjetor i punës së ndërmarrjes publike lokale "Gjelbër", SHA, për vitin 2023, si dhe raporti i punës për periudhën janar - prill 2024.

Lidhur me raportin vjetor të punës së kësaj ndërmarrjeje, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Rrahman Qerimi, anëtar i Komisionit komunal të aksionarëve nga ekzekutivi.

**Feim Osmani** tha se ky raport nuk i plotëson kushtet për t'u diskutuar sot, pikërisht për shkak të disa gjetjeve dhe për shkak të mospasjes së planit të biznesit, kështu që konsideroj që do duhej të trajtohej fillimisht aspekti financiar i ndërmarrjes, për të mos i shkaktuar probleme financiare, pastaj të merren hapa të cilët kanë të bëjnë me investime tjera.

Sidoqoftë, krahasimi me periudhën e vitit paraprak nuk është adekuat, komisionerët ose menaxhmenti do duhej të na e sjellin një plan të biznesit, se kështu e parashevë edhe rregullorja, dhe ne në bazë të realizimit të planit do ta konstatonim se ka operuar me sukses apo jo ndërmarrja.

**Faton Zeka**, fillimisht kërkoi të dij arsyen e ndryshimit të emrit të ndërmarrjes prej "Hortikultura" në "Gjelbër". Ne si anëtarë të Kuvendit jemi të interesuar me ditë përveç punëve teknike dhe raportit financiar dhe respektimi i Ligjit të punës. Po ashtu, kërkojmë të dijmë se sa punëtorë ka ndërmarrja, rapporti i udhëheqjes së ndërmarrjes, me punëtorë, sidomos me punëtorë që kanë dekada pune në ndërmarrje, sepse ne kemi informata që punëtorët që janë punësuar kohëve të fundit, kanë benefite nga drejtoria përkatëse në raport me punëtorët e vjetër të ndërmarrjes.

Kjo ndërmarrje mirëmban zhvillimin e hapësirave të gjelbra në lagjet e ndryshme të kryeqytetit, ku ndër to përfshihen lagjet e qytetit dhe Parku i Gërmisë, por nuk përfshihen çerdhet publike ose ato me bazë në komunitet. A mund të bëhet një bashkëpunim me këto institucione parashkollore dhe të mirëmbahen nga ndërmarrja.

**Gëzim Mehmeti** kërroi të dijë se sa është sipërfaqja e tërësishme e gjelbër që mirëmbahet nga kjo ndërmarrje, po ashtu kërroi që në raport të ketë më shumë detaje, si p.sh. rrëth numrit të pëunëtorëve që marrin pagë mujore në këtë ndërmarrje etj.

**Lindita Rexhepi**, falënderoi punëtorët e kësaj ndërmarrjeje, të cilët bëjnë një punë të palodhshme çdo ditë për qytetarët e kryeqytetit, me theks të veçantë për mirëmbajtjen e parkut në lagjën "Ulpiana".

**Ermal Osmani** kërroi nga kjo ndërmarrje, që edhe në hapësirat gjelbëruese në lagjen "Bregu i Diellit" të mbillen lule dekorative.

Lihur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime shtesë dha Rrahman Qerimi, anëtar i Komisionit komunal të aksionarëve nga ekzekutivi.

### Pika e dhjetë

#### Pyetje dhe përgjigje.

#### Arbnora Berisha, për kryetarin e Komunës:

- Punëtoret që kanë qenë pjesë e stafit të çerdheve që nga paralufta, të cilat janë pranuar në ato çerdhe me kontratë, si serviruese të fëmijëve, që kanë punuar për një kohë shumë të gjatë në ato çerdhe, këto punëtore janë marrë nga çerdhja dhe janë dërguar si shërbyese ose serviruese në Kuzhinën Qendrore. Po ashtu, një punëtore së fundmi është dërguar në një tjetër qendër sociale, në vend që të sistemohen njëherë e mirë dhe të mbesin në kuadër të Kuzhinës Qendrore, nuk është e drejtë që ato çdo ditë të qëndrojnë me stres, duke mos e ditur se çfarë do të ndodhë tutje me to. Kërkojmë nga ekzekutivi që këtyre punëtoreve t'iu bëhet një zgjidhje, që mos të përfundojnë derisa të dalin në pension, të transferohen sa andej, sa këndej dhe kërkesa e tyre të realizohet.

#### Besart Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për kryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisësë Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisësë Shëndetësisë:

- Banorët e lagjes "Kodra e Trimave" kanë një ankesë për objektin që është në shkollën filllore Asim Vokshi, i cili është shndërruar venqëndrim i narkomanëve, si dhe përveç mbeturinav që janë prezent aty, po rrezikohen nxënësit e kësaj shkolle. Po ashtu në këtë lagje në rrugën "Nexhami Llumica", vendi i quajtur te Bazeni, është krijuar një deponi e mbeturinave, si dhe në rrugën "Agim Osaj", andaj kërkojnë pastrimin e këtyre rrugëve nga mbeturinat.
- Gjithashtu, në këtë lagje banorët kërkojnë edhe vendosjen e "policëve të shtrirë" në rrugën "Mon Bala", ku për shkak të shpejtësisë së veturave po rrezikohetjeta e banorëve, e në veçanti e fëmijëve.

- Shoqatat e dëshmorë të UÇK-së kanë bërë një kërkesë në muajin e kaluar, për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës në lagjen "Pepaj" në Mramor, me një gjatësi prej 1.2 km, ku jeton edhe familja e dëshmorit Xhavit Gashi.
- Po ashtu, banorët e fshatit Grashicë kërkojnë rregullimin e rrugës, apo degëzimin e dy rrugëve ngjité me rrugën "Sofra e Gollakut", me një gjatësi prej 1.1km.
- Banorët e lagjes "Ulpiana" ankohen për mungesë të ulëseve në parkun afër rrugës "Mak Dizdar", kërkojnë vendosjen e tyre, që është shumë e nevojshme për të moshuarit?
- Qytetarët e Prishtinës ankohen se nuk po pastrohet rrugët në përgjithësi në kryeqytet.
- Kur do të fillojë dezinfektimi në lagjet dhe fshatrat e Prishtinës?
- Qytetarët të cilët ecin dhe vrapojnë në Gërmë, jan të rezikuar nga disa motoristë të pandergjegjshëm, të cilët hyjnë në këtë terren të ndaluar për motorr dhe rezikoja jetën e tyre.
- Banorët e lagjes "Arbëria", por edhe në përgjithësi të qytetarëve që e vizitojnë këtë park, kërkojnë të vendosin një çezmë për ujë, pasi që është shumë e nevojshme për ata qytetarë që vizitojnë këtë park.

Lidhur me pyetjet e parashtuara nga z. Krasniqi, përgjigje dhanë Krenar Xhaferi, drejtor, dhe Bekim Brestovci, drejtor.

#### **Gëzim Mehmeti, për kryesuesin e Kuvendit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Kërkoj nga kryesuesi i Kuvendit që ta marrë një iniciativë për fillimin e procedurës për ndryshimin e Statutit të Komunës.
- Në "E-prokurim" shihet se kanë përfunduar kontratat e mirëmbajtjes së ndriçimit dhe kërkoj të dijë se kur do të fillojë realizimi i saj, sepse Prishtina ka nevojë imediate, kur presim fillimin e veprimit në këtë drejtim.

Lidhur me pyetjen e z. Mehmeti, përgjigje dha Bekim Brestovci, drejtor.

#### **Faton Zeka, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Cilat janë kriteret që janë përdorur për ndarjen e qoshqeve të reja në shesh, sepse në rrugën "Qamil Hoxha" ka qenë i vendosur një shitës ambulant i akulloreve edhe iu ka ndërruar ai pozicion dhe ka dalë në rrugën "Rexhep Luci" dhe e ka nxënë pozicionin e shitësit ambulant Enver Gashi, i cili ankohet, sepse për njëmbëdhjetë vjet me radhë e ka përdorur atë lokacion dhe nga kjo pakënaqësi ka fillua edhe të bëjë protestë para objektit të Komunës. A ka mundësi me ditë çfarë kritere janë vendosur dhe pse shitësit ambulantë të akulloreve iu ka caktuar ai lokacion, e jo lokacion i ri?
- A ka mundësi që në bashkëpunim me Trafikun Urban, linjës 7C të cilës i'u ka ka zgjatë rruga deri te rrethi i ETC-së, që është mes rrugës Prishtinë - Fushë Kosovë, me

e ndërprerë, pasi që po shkakton shumë vonesa, ku përveç qendrës Central Park, nuk i shërben aspak qytetarëve.

Lidhur me pyetjet e parashtraua nga z. Zeka, përgjigje dha Bekim Brestovci, drejtor.

**Ermal Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Në shtator të vitit 2022 "Infrakos" ka dhënë pëlqimin e vendosjes së pllakës së dëshmorit Ismet Krasniqi, pasi është pronë e hekurudhave afér Xhamisë së Llapit, ku edhe aty ka rënë dëshmor në vitin 1989, edhe Komuna nuk e ka marrë ende asnje hap.  
A pritet që Komuna ta marrë ndonjë veprim për vendosjen e kësaj pllake.

Lidhur me pyetjen e z. Osmani, përgjigje dha Bekim Brestovci, drejtor.

**Pika e njëmbëdhjetë**

**Të ndryshme**

**Feim Osmani**, kërkoi nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, që në fshatin Besi, tek QMF-ja dhe çerdhja, të sillen kontejnerët e plastikës, për arsy se kontejnerët ekzistues janë dëmtuar bukur shumë dhe gjendja në aspektin e pastërtisë atje është shumë e rëndë.

*Mbledhja përfundoi në orën 17:40.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Fehmi Kupina



---

Faqe12nga12